	Këshilli Ndërkombëtar për Rrjetet e Mëdha Elektrike Komiteti Nacional CIGRE Kosovë  <b>RREGULLORE E PUNËS          PËR          KOMITETET STUDIUESE</b>	<b>KN CIGRE KO</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 1 / 5</i>

Në bazë të Nenit 18 të Statutit të Komitetit Nacional CIGRE Kosovë, Bordi Teknik Nacional i KN CIGRE KO në takimin e mbajtur me datë 26.03.2018 ka miratuar:

## RREGULLOREN E PUNËS për Komitetet Studiuese(KS) të KN CIGRE KO

SHOQATA ELEKTROTEKNIKE E KOSOVËS Komiteti Nacional CIGRE Kosovë - KN CIGRE KO	
Nr. <u>30</u>	Dt. <u>26,03,2018</u>
PRISHTINË	

### Neni 1

Komitetet Studiues(KS) janë organe profesionalo - shkencore të Komitetit Nacional CIGRE Kosovë, të cilat studiojnë problemet e fushave të caktuara të punës së KN CIGRE KO.

Detyra themelore, mënyra e zgjedhjes, forma organizative etj. janë të përcaktuara me Statutin e KN CIGRE KO, Neni 6, Neni 19 dhe Neni 20 të cilat janë të detyrueshme për punën e Komiteteve Studiuese.

### Neni 2

Detyrat bazë të Komiteteve Studiuese janë si më poshtë:

- këmbimin e njohurive profesionale, përvojave dhe opinioneve të inxhinierëve, specialistëve dhe ekspertëve rreth problemeve nga fushat e veçanta të punës së Komiteteve Studiuese;
- ndërmarrjen e iniciativave në mes anëtarëve të Komiteteve Studiuese posaçërisht për studime të problemeve interesante, përmes studimeve dhe analizave ose duke monitoruar dukuritë në eksploatim/shfrytëzim;
- studimin e problemeve të theksuara nga ekspertë, kompani(ndërmarrje), organizata etj. brenda dhe jashtë vendit;
- studimin e problemeve të paraqitura nga anëtarët e KN CIGRE KO ose nga organizatat e interesuara të punës;
- shqyrtimin e çështjeve të paraqitura, sondazhet, etj. nga fushat e veçanta të punës së Komiteteve Studiuese nga KN CIGRE KO dhe nga KS;
- paraqitjen e qëndrimit të KS për problemet e caktuara të shqyrtuara në takimet e Komiteteve Studiuese ose në mbledhjet e KN CIGRE KO përmes raporteve grupore ose individuale, ose punimeve, në mënyrë që të fillojë diskutimi në bazë më të gjerë, e për të marrë konfirmimin ose korrigjimin e qëndrimit në fjalë;
- bashkëpunimin me Komitetet e tjera Studiuese mbi problemet e përbashkëta;

	<p>Këshilli Ndërkombëtar për Rrjetet e Mëdha Elektrike Komiteti Nacional CIGRE Kosovë</p> <p><b>RREGULLORE E PUNËS PËR KOMITETET STUDIUESE</b></p> <p><i>ver. 1.0</i></p>	<p><b>KN CIGRE KO</b></p> <p><i>page 2 / 5</i></p>

- delegimin e anëtarit të KS në punën e organizatave tjera profesionale, nëse është e nevojshme;
- përcjelljen dhe analizimin e ngjarjeve profesionale dhe takimeve nga fushat e punës së Komiteteve Studiuese në vend dhe jashtë vendit;
- pjesëmarrjen në përgatitjet për mbledhjet profesionale, propozimin e temave preferenciale, organizimin e diskutimeve dhe përgatitjen e raporteve e konkluzioneve;
- kujdesin e shtuar të nivelit profesionalo-shkencor në përgatitjen e punimeve të shkruara dhe prezantimeve nga fushat e veçanta të punës së Komiteteve Studiuese, në konferencat që organizohen nga KN CIGRE KO gjatë pjesëmarrjes në ngjarjet jashtë vendit;
- zgjedhjen e recensentëve, pranimin ose refuzimin e punimeve të përgatitura për konferenca, në përputhje me Rregulloren e Punës së KN CIGRE KO për Konferenca;
- organizimin dhe stimulimin e punimeve të shkruara dhe prezantimin e tyre në takimet e nivelit profesional;
- bashkëpunimin me organizata tjera kompetente në hartimin e rregulloreve, dispozitave dhe standardeve;
- punë të tjera profesionale nga fusha që konsiderohet të jetë me interes dhe dobi.

### **Neni 3**

Puna e Komiteteve Studiuese kryhet në takimet e rregullta të KS, simpoziume dhe konferenca, e sipas nevojës edhe në takimet profesionale për të cilat Komiteti Studiues përkatës është i interesuar nga fusha e veçantë e punës.

Takimet e Komiteteve Studiuese mbahen sipas nevojës, por të paktën një herë në vit.

Takimet e Komiteteve Studiuese janë publike dhe mund të ndiqen nga ekspertë të interesuar të cilët nuk janë anëtarë të KN CIGRE KO.

### **Neni 4**

Takimet thirren nga Kryesuesi i Komitetit Studiues, sipas marrëveshjes nga mbledhja e mëparshme e KS, sipas nevojës të paraqitur ose sipas propozimit të paktës 50% të anëtarëve të Komitetit Studiues përkatës. Rendi i ditës i takimit së bashku me materialin e nevojshëm duhet të dorëzohet tek secili anëtarë i KS si dhe te Sekretari i KN CIGRE KO së paku 7 ditë kalendarike para datës të mbajtjes së takimit.

	<p>Këshilli Ndërkombëtar për Rrjetet e Mëdha Elektrike Komiteti Nacional CIGRE Kosovë</p> <p><b>RREGULLORE E PUNËS PËR KOMITETET STUDIUESE</b></p>	<p><b>KN CIGRE KO</b></p>
	<p><i>ver. 1.0</i></p>	<p><i>page 3 / 5</i></p>

#### **Neni 5**

Puna e secilit Komitet Studiuës drejtohet nga Kryesuesi i Komitetit Studiuës përkatës. Kryesuesi i KS është iniciator kryesor i aktiviteteve dhe veprimeve të Komitetit Studiuës në realizimin e detyrave të përcaktuara në Nenin 3 të kësaj Rregullore. Ai thërret takimet e Komitetit Studiuës dhe menaxhon punën e tij. Në mungesë të tij, kryesimi i atij takimi bëhet nga zv. Kryesuesi.

Kryesuesi i Komitetit Studiuës ndihmohet nga zv. Kryesuesi, i cili:

- kujdeset për dërgimin e ftesave për anëtarët e Komitetit Studiuës dhe Sekretarit të KN CIGRE KO;
- mbanë Procesverbalin e takimit të Komitetit Studiuës, të cilin më pas ua dërgon të gjithë anëtarëve të Komitetit Studiuës dhe Sekretarit të KN CIGRE KO;
- kujdeset për detyrat administrativo-teknike gjatë organizimit të konferencave dhe ngjarjeve të tjera të ngjashme;
- kujdeset që pagesa e anëtarësisë individuale vjetore të realizohet me kohë nga anëtarët e Komitetit Studiuës përkatës, e cila duhet të bëhet te Sekretari i KN CIGRE KO, i cili duhet të mbajë shënime përkatëse për këtë çështje;
- bën kryesimin e takimit të Komitetit Studiuës kur Kryesuesi i Komitetit Studiuës nuk është prezent;

#### **Neni 6**


Kryesuesit e Komiteteve Studiuëse duhet të përgatisin dhe dorëzojnë një Raport vjetor lidhur me aktivitetet e Komitetit Studiuës në KN CIGRE KO. Ky raport duhet të përfshijë vështirësitë eventuale në punë, të arriturat si dhe propozimet dhe planet për periudhën(vitin) e ardhshme. Raportet duhet të dorëzohen te Sekretari i KN CIGRE KO deri në fund të muajit Janar për vitin e kaluar(paraparak).

#### **Neni 7**

Komitetin Studiuës e përbëjnë: anëtarët e Komitetit Nacional, profesorë, ekspertë, specialist dhe inxhinier të shquar të cilët janë të gatshëm të punojnë në mënyrë aktive në detyra që caktohen nga Komitetet Studiuëse. Angazhimi i secilit anëtarë në Komitetet Studiuëse kërkon miratimin paraparak të Anëtarit Kolektiv të tyre.

Numri minimal i anëtarëve për funksionimin e Komiteteve Studiuëse është 5 anëtar ndërsa numri maksimal nuk është i fiksuar apo i kufizuar. Numri i anëtarëve nëpër KS përcaktohet nga numri i të kualifikuarve të interesuar dhe të përzgjedhur si ekspertë të fushës përkatëse;

#### **Neni 8**

	<p style="text-align: center;">Këshilli Ndërkombëtar për Rrjetet e Mëdha Elektrike Komiteti Nacional CIGRE Kosovë</p> <p style="text-align: center;"><b>RREGULLORE E PUNËS PËR KOMITETET STUDIUESE</b></p> <p style="text-align: center;"><i>ver. 1.0</i></p>	<p style="text-align: center;"><b>KN CIGRE KO</b></p> <p style="text-align: right;"><i>page 4 / 5</i></p>
---	---	---

Anëtarët e rinj në Komitete Studiuese zgjedhen me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të KN CIGRE KO gjatë mbledhjes së Kuvendit, në përputhje me Nenin 7 të kësaj Rregullore, me iniciativën e vet kandidatit, me propozimin e Komitetit Studiues ose me propozimin e Anëtarit Kolektiv, e në bazë të të dhënave relevante të dëshmuara për punën e tij profesionale.

Zgjedhja e anëtarëve të rinj në Komitete Studiuese, fillimisht prezantohet nga Sekretari, propozohet nga Bordi Teknik Nacional e pastaj konfirmohet nga Kuvendi i Komitetit Nacional(KN CIGRE KO), ndërsa të dhënat evidentuese për secilin anëtarë të angazhuar në KS mbahen nga Sekretari i KN CIGRE KO.

#### **Neni 9**

Kohëzgjatja e të qenit anëtar i Komitetit Studiues është i përcaktuar përmes Nenit 19 të Statutit të KN CIGRE KO. Mandati i anëtarit të Komitetit Studiues përfundon me kërkesë të vet anëtarit, mos pagesës së tarifës individuale vjetore të anëtarësisë në KS, ose në bazë të Vendimit të vet Komitetit Studiues. Lidhur me përfundimin apo ndërprerjen e anëtarësisimit si anëtarë i Komitetit Studiues duhet informuar me kohë Sekretarin e KN CIGRE KO.

#### **Neni 10**

Me qëllim të punës më të mirë në kuadër të aktiviteteve të veta, secili Komitet Studiues mund të formojë Grup Punues për një çështje specifike.

Nëse është e nevojshme, Grupi Punues mund të përbëhet nga anëtarë të disa Komiteteve Studiuese dhe/ose mund të përfshijë ekspertë të jashtëm të cilët nuk janë anëtarë të KN CIGRE KO.

#### **Neni 11**

Puna dhe angazhimi në Komitete Studiuese është krejtësisht vullnetare. Shpenzimet eventuale të pjesëmarrjes së anëtarëve në punën e Komiteteve Studiuese duhet të mbulohen nga Anëtari Kolektiv apo nga vet anëtarët e Komitetit Studiues.

#### **Neni 12**

Mjetet financiare që mund të shpenzojnë individët si anëtarë të Komiteteve Studiuese në kuadër të aktiviteteve të tyre përcaktohen nga planet financiare vjetore ose nga plani i shpenzimeve në kuadër të organizimit të Konferencave(Këshillimeve). Kërkesa për shumën e nevojshme për përkrahje financiare përgatitet dhe dorëzohet nga Kryesuesi i KS te Sekretari i KN CIGRE KO ndërsa miratohet nga Bordi Teknik Nacional. Në raste të



	Këshilli Ndërkombëtar për Rrjetet e Mëdha Elektrike Komiteti Nacional CIGRE Kosovë  <b>RREGULLORE E PUNËS          PËR          KOMITETET STUDIUESE</b>	<b>KN CIGRE KO</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 5 / 5</i>

jashtëzakonshme, urgjente dhe të justifikuara, Vendimi për shumën e nevojshme financiare mund të merret gjithashtu edhe nga Kryesuesi i KN CIGRE KO.

#### **Neni 13**

Koordinimi i punës së Komiteteve Studiuese dhe mosmarrëveshjet e mundshme që nuk mund të zgjidhen brenda vet Komitetit Studiues duhet të delegohen për zgjidhje në Bordin Teknik Nacional të KN CIGRE KO.

#### **Neni 14**

Nëse në mbledhjet e Komitetit Studiues përveç diskutimit, pyetjeve të ekspertëve dhe këmbimit të mendimeve nxirren edhe konkluzione, atëherë ato duhet të miratohen nga së paku gjysma e anëtarëve që janë prezent gjatë mbajtjes së atij takimi të Komitetit Studiues.

Konkluzionet dhe Rekomandimet e vendosura në Procesverbalin e miratuar nga mbledhjet e Komitetit Studiues kanë karakterin e propozimit në rastin e çështjeve që Statuti i vë në kompetencë të Bordit Teknik Nacional ose të Kuvendit të KN CIGRE KO.

#### **Neni 15**

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregullore kryhen sipas procedurës së njëjtë sikurse gjatë miratimit të saj.

#### **Neni 16**

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj nga Bordi Teknik Nacional (BTN) i KN CIGRE KO.



Kryetar i KN CIGRE KO  
(Kryesues i BTN-së)

*Mehmed Bula*

Prof. Dr. Mehmed BULA

Datë: 26.03.2018, Prishtinë